

Data 24.07.2023

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës – PUNË  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE  
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

- **Rrjeti i Kanalizimeve në zonat periferike të Qytetit Burrel dhe largimi i ujërave të zeza të fshatit Muzhak**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- **45000000-7 – Punë ndërtimi**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

- 321,560,520 (treqind e njëzet e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

Në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit Nr.162 / 2020 “Për prokurimin publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78,pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, njesia e prokurimit prane autoritetit kontraktor Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES / KUALIFIKIMIT**

**Ofertuesi deklaron se:**

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë

- objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prejkushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

**Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër. Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :**

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

*Sipas percaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes / Kualifikimit pika 1 e Shtojcës 7.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat e pikes 1, Shtojca 7.

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2020, 2021, 2022 të konfirmuara me vule pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

**Shënim:** Duke qenë se afati ligjor për të dorëzuar Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, pranë Autoriteteve Tatimore është muaji Korrik; në rast se operatori ekonomik ofertues nuk e ka përgatitur Akt Ekspertizën për bilancin kontabël të vitit 2022 deri në datën e dorëzimit të ofertave, atëhere mos paraqitja e këtij dokumenti në këtë rast nuk paraqet kusht për s`kualifikim.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**2.2.2** Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**2.2.3.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2022 dhe për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

**Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas Shtojcës Nr. 8 të DST-së. Në rast Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetimin/e lëshuar nga Bashkia / Komuna me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetedeklarimit të kryer në Shtojcën Nr. 8 të DST-së.**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare;**...3) Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë **një xhirovjetore minimale të caktuar.** Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin **informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.** Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët

*ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”*

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”

***Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:...b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;***

*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacionenë bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Gjithashtu, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

**Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998** “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

**Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5** datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar Pika 3.12 e tij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr. 25 date 10.05.2018** “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 9 i tij ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”.

**Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009** “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” gjykojmë që të kërkojmë xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2020, 2021, 2022) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Gjithashtu njësia e prokurimit kerkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga çdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

## **2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:**

### **2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

### **Ose**

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

**Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.**

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:**

Ne rast se punimet jane kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme te realizuar me ente publike, duhet te paraqese formular vleresimi leshuar nga Investitori sipas Shtojces 9 dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet jane kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi te përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet te paraqese vertetime te shoqeruara me faturat tatimore të shitjes, ku te shënohen datat, shumat, natyra e punes se kryer dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

*Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*

*Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).*

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i Bashkimit te Operatoreve.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe **përvojën e nevojshme** për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

***Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”***

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *“Për të provuar përvojën mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) **punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku tëshënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme***

*të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afatii përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumentitjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

**Njësia përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.**

Sipas këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacioneve ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhesituacionet përfundimtare si dhe formular vleresimi për punët e kryera me entet publike, për të patur mundësi të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktoredhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqenese se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoritetit të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

### **2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës**

- a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqese liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.



Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë profesionale të shoqërisë, te vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- **Kategoria NP- 1** Punime germimi ne toke **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP- 2** Ndërtime civile dhe industriale **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP- 7** Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje **Klasifikimi E**
- **Kategoria NP-11** Ndertime per n/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise) **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS- 4** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS- 8** Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-14** Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni Tv,etj **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** Punime topogjeodezike **Klasifikimi A**

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s`kualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënllorit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës.

Konkretisht llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

### **Sipas VKM Nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar:**

**Kategoria N.P - 1** “Punime gërmimi në tokë” *Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në vullmë tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

Kjo kategori është kërkuar duke patur parasysh se janë të parashikuara në preventiv punimet të tilla si gërmime dhe me eskavator me goma në kanal, gërmim themelesh, mbushje, rrafshim, ngjeshje me material të gërmuar me parë etj, procese të cilat do të kryhen me qëllim shtrimin e tubacioneve të rrjetit të kanalizimeve si dhe gërmimet që do të bëhen për ndërtimin e Impiantit të trajtimit të ujerave të zeza. (fq 21 e Specifikimeve teknike të Impiantit dhe Preventivi të publikuara në SPE).

Në preventiv janë parashikuar në total volume dhera të gërmuara rreth 63,000 m<sup>3</sup>. Këto procese përshkruhen edhe në Specifikimet teknike Kapitulli 2 “Punimet e dheut”

**Kategoria NP- 2 Ndërtime civile dhe industriale** *Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.*

Kjo kategori është kërkuar duke patur parasysh punimet në preventiv të cilat përfshijnë ndërtim të ndërtesave civile, magazinimi, laborator, kabina elektrike si dhe të shprehura edhe në Specifikimet Teknike të Rrjetit të kanalizimeve Kapitulli 5. Gjithashtu këto punime parashikohen edhe gjatë ndërtimit të Impiantit të trajtimit të ujerave të zeza sic përcaktohet në Specifikimet Teknike të Impiantit Fq 17 ku citohe:

**“Ndertim i Zyres Operative Kompletohet kati i pare b/a dhe me murature i ndertesës duke përfshirë Zyra, Laboratori, Dhoma e Magazinimit / Ndërrimit, Etj”**

**Kategoria N.P-7** “Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje” *Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur njëshërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjellsat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.*

Kjo kategori licence i referohet se pari **objektit të kontrates** dhe se dyti punimeve të parashikuara në preventiv konkretisht furnizim vendosje tuba HDPE për ndertimin e Rrjetit të Kanalizimeve , gropat septike, punimet për dekantuesin, pusetat e shkarkimit, stacioni i pranimit të mbetjeve, dhoma e tharjes së llumrave, kanalizimet dhe ne teresi punimet për Impiantin e Trajtimit të ujerave të Zeza.

**Kategoria NP-11** Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë **përfshin në menyre të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.**

Eshtë vendosur kjo kategori punimesh duke patur parasysh ndertimin e impiantit dhe komponentet perberes te tij si dhe specifikimet teknike te Impiantit ku percaktohet “*Kabina Elektrike Kabina e re elektrike do të jetë pjesë e ndërtesës operationale dhe do të strehojë transformatorin, centralin MV dhe panelin kryesor LV, të nevojshëm për të furnizuar me energji objektin*” (Faqe 17 dhe faqe 21 Specifikimet teknike).

Gjithashtu në preventiv janë parashikuar punime të mirefillta të natyrës elektrike si furnizim vendosje Gjenerator, Automat, Panel, transformator fuqie, mates fuqie, mates i energjise elektrike, shtylla betoni 20 KV, kabina e re elektrike, (fq 17 specifikimet teknike te impiantit), punime në TM dhe TU Instalim elektrik të kablllove, shtresat dhe tubave të furnizuar nga bordi i shpërndarjes së tensionit të ulët, kablllo PVC, puseta elektrike, tokezime etj.

**“Furnizuesi duhet të jetë në gjendje të dëshmojë se posedon përvojë të madhe në fushën e Pajisjeve elektrike të tensionit të mesem MV ” Fq 32 Specifikime Teknike te Impiantit**

**Kategoria NS-4** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Kjo kategori license eshte vendosur duke patur parasysh punimet ne impiant parashikuar ne preventiv ku perfshihen punimet per magazine, laboratori, tualeti, kabina elektrike, konkretisht suvatime, shtresa dysHEMEJE, lYerje etj.

**Kategoria N.S 8** “Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri”, Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga element të drejtë të trajtuar përpara.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv si ndertim puseta betoni, tombino me tuba betoni mbi shtrese betoni, shtresa betoni, struktura monolite betoni etj. Keto punime do te jene te pranishme gjate ndertimit te Rrjetit KUZ (Pershkruar ne Kapitullin 3 Specifikimet teknike te Rrjetit te kanalizimeve). Gjithashtu, keto punime pershkruhen edhe ne specifikimet teknike te Ndertimit te Impiantit te trajtimit te ujerave te zeza, duke perfshire ndertimin e njesise se paratrajtimit, rezervuarit dekantues, (i cili do te jete rezervuar nëntokësor prej betoni të armuar), gropa septike e cila do te jete rezervuar beton arme, etj.

#### **Specifikimet teknike Faqe 74**

**“Te gjitha veprat hidroteknike** qe perfshihen ne kete projekt si pusetat e kontrollit, ankerat, do te jene prej **betoni dhe betoni te armuar C 20/25**. Madhesia e pusetave eshte ne varesi te thellesise dhe tubacionit qe do te lidhen me të. *Betoni do të jetë beton hidroteknik, pasi nga gërmimet do të kemi ujëra nëntokësorë agresivë !”*

**Kategoria NS-14** Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni Tv, etj eshte kerkuar per keto arsye:

Kjo kategori licence i referohet punimeve elektrike te cilat jane te domosdoshme dhe pasqyrohen ne preventiv ne punimet e laborator, magazine, punimet per rrjetin e ndricimit, etj, punime te cilat jane pjese e pandare e ndertimit te impiantit percaktuar edhe ne Kapitullin 8.3 Specifikimet Teknike te Impiantit te trajtimit te ujerave te zeza publikuar ne SPE.

**Kategoria NS 18** Punime topogjeodezike. Kjo pikë licence përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike etj. Gjithashtu është vendosur në përputhje me punimet që do të realizohen bazuar në projektin e zbatimit dhe ne preventivin e punimeve.

Konkretisht kjo kategori licence eshte e domosdoshme per piketimet e kanaleve qe do te germohen dhe sistemimet topografike. Eshte kerkuar sipas parashikimeve te hollesishme ne specifikimet teknike te rrjetit KUZ si dhe Raportit topografik.

Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kërkuar duke u bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar.

#### **b) Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, sipas standardeve:

- Certifikate ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, objekti i së cilës të jete në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikate ISO 14001-2015 “Për sistemin e menaxhimit të mjedisit”, objekti i së cilës të jete në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikate ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, objekti i së cilës të jete në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikate ISO 1452-1:2009 “Për Sistemet e tubacioneve plastike për furnizimin me ujë, kullimet dhe kanalizimet nëntokësore dhe mbitokësore nën presion” ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jete në përputhje me objektin e prokurimit.
- Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të perkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë për të realizuar, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata të leshuara nga një organ i**

*vlerësimin të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime.

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qene në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektine kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Konkretisht **Certifikate ISO 9001 - 2015** “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi e cila mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj.

**Certifikate ISO 45001-2018** “Per sistemin e menaxhimit teshendetit dhe sigurimit ne pune” mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve etj.

c) Ne perputhje me kerkesat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor ne specifikimet teknike dhe preventiv, per listen e artikujve, si me poshte:

- Tuba te brinjezuar HDPE SN8
- Tuba betoni dhe kapak pusetash te parafabrikuar beton arme
- Tuba dhe rakorderi ujesjellesi PE
- Komponentet perberes te Impiantit te trajtimit te ujrave te zeza

**Operatori Ekonomik duhet te paraqese:**

1. Autorizim te Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributor i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave nenshkruar jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument te paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar ne gjuhen zyrtare shqipe.
2. Katalogun / et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit / ve per listen e mesiperme te artikujve ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen. Shenim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.
3. Të gjitha materialet e mesiperme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane. Per keto materiale Operatori Ekonomik duhet te paraqese vetedeklarim qe deklaron se sistemi i menaxhimit te cilesise te prodhuesit / ve eshte sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjate procesit te vlerësimit të dokumentacionit.

**Shenim:** Te gjitha normat dhe standartet e kerkuara ne specifikimet teknike te publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve te tyre, standarteve shqiptare SSH te miratuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit DPS, ne ato raste kur keto standarte jane unifikuar nga kjo Drejtori.

**Argumentimi:** Paraqitja e ketyre dokumenteve eshte vlerësuar nga njesia e prokurimit pasi duke qenë se në objektin e prokurimit kemi të bëjmë me blerjen e materialeve dhe pajisjeve që do të vendosen në punimetobjekt kontrate, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: *Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre*, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

### **2.3.3 Operatori Ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës si dhe punonjësit specialistë me çertifikimet përkatëse, si më poshtë:**

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën 60 (gjashtedhjetë) punonjes për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.

**Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:**

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

b) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, **Drejtuesit Teknik** si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 2 (dy)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet / Topograf 1 (një)

Drejtuesit Teknik të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë, të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, të kësaj kontrate pune të vlefshme, të deklarojnë se nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Operatori Ekonomik, përmbushjen e këtij kriteri duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga administratori i shoqërisë për personelin kryesor, Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

**Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas Shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, për Drejtuesit Teknik duhet të dorëzojë dokumentacionin:**

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate
- Diplomë profesionale
- CV



- Libreze pune
  - Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas parashikimeve të Ligjit Nr.8734 datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.
- c) Operatori Ekonomik për të realizuar objektin e prokurimit, duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmerishtë të përfshirë në licencën e shoqërisë, stafin inxhinierik si më poshtë:
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
  - Inxhinier Elektronik / Inxhinier i teknologjisë së informacionit 1 (një)

**Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas Shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, për stafin e inxhinierëve të sipërcituar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:**

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate;
  - Diplomë profesionale
  - Libreze pune
  - Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas parashikimeve të Ligjit Nr.8734 datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr.13/2013.
- d) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën **30 (tridhjetë)** punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, me profesione si më poshtë:
- **3 (tre) hidraulike**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
  - **3 (tre) teknik ndertimi**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
  - **10 (dhjetë) muratore**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- **2 (dy) saldatore** shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- **2 (dy) specialiste elektrikiste**, me minimumi kategorine e III-te te kualifikimit, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” .
- **2 (dy) specialiste karpentier** shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
- **2 (dy) hekurkthyes** shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
- **1 (nje) mekanik**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
- **1 (nje) specialist hidroizolues** shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”
- **4 (kater) shofere** për drejtimin e mjeteve kamiona, shoqëruar me kontratë pune te vlefshme dhe leje drejtimi me kategorine ”C” dhe/ose ”CE” dhe/ose ”D” dhe/ose ”DE” leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit te Transportit Rrugor.
- **Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas Shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet te dorezoje dokumentacionin si me poshte:**
  - Kontratë pune e vlefshme gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate.
  - Diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
  - Per specialistet e mesiperm (*me perjashtim te punonjesve shofere*) te paraqiten Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme te lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga

subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve sipas parashikimeve të Ligjit Nr.8734 datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

e) Operatori Ekonomik duhet të ketë të pakten :

- **4 (kater) Manovratore / Eskavatoriste / Automakinist**

Te cilet mund të jene pjese e stafit ose të kontraktuar me kontrate pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në perfundimin e kontrates.

**Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës sipas Shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:**

- Deshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;
- Kontrate pune / shërbimi të vlefshme;
- Kartele personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

f) Operatori Ekonomik duhet të ketë të pakten :

- 1 (një) punonjës të certifikuar me deshmi trajnimit si “Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë” të leshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kerkese kjo në përputhje me Ligjin Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier". Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) "Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë", sipas zerave të punimeve / shërbimeve / mallit që do të marrë përsiper të realizojë sipas akt marrëveshjes / kontrates së bashkepunimit.

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjeket të jene të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2013, duhet të plotësojë këtë kerkese, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsiper të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkepunimit.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: *“1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës*

*Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

*Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret tjeratë veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

Gjithashtu, me qëllim ndërtimin e objektit të vepres sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **60 punonjës**, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njesia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, prej periudhën 20 muaj , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve perfshihen punonjësit inxhinierë, specialiste, punonjës të kualifikuar, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj, duke patur parasysh njekohesisht volumin e punimeve. Duke qene se ky objekt perfshin ndertimin e rrjetit KUZ dhe impiantit të trajtimit te ujerave te zeza, si dhe duke u bazuar ne grafikun dhe llojin e punimeve qe do te kryhen si: ndertim i rrjetit kanalizime, germime, ngjeshje, sistemime, shtrim tubacionesh HDPE, hidroizolime, ndertim i Impiantit me te gjithë komponentet perberes te tij, punime keto te cilat duhet te realizohen brenda afatit te parashikuar te objektit ne grafikun e punimeve, 20 muaj, te shtrira ne zonat periferike te qytetit te Burrelit dhe fshatin Muzhak, lind nevoja per kete fuqi te percaktuar punetore. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Konkretisht:** Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. **Drejtuesi teknik është përgjegjës** për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njesia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës që i është bërë preventiv të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashtröjmë:

Jane kerkuar **inxhinier ndërtimi** te cilet janë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve të pranishme në preventiv si: **ndërtesa civile, magazinimi, laborator, kabina elektrike, etj.** **Gjithashtu inxhinieri i ndërtimit do të mbikqyre të gjitha kategoritë e punimeve të betonit, konkretisht ndërtim puseta betoni, prishje mure betoni, struktura monolite beton etj.**

Keto punime do të jenë të pranishme edhe gjatë ndërtimit të Rrjetit të kanalizimeve (Pershkruar edhe në Kapitullin 3 Specifikimet Teknike) ashtu edhe në ndërtimin e Impiantit të trajtimit të ujerave të zeza.

Eshtë kerkuar **inxhinier hidroteknik** i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve voluminoze hidraulike lidhur me zërat e preventivit të punimeve, kontrollin e gjithë punimeve që kanë lidhje me furnizim vendosjen e tubacioneve të rrjetit kanalizimeve si dhe punimeve për ndërtimin dhe funksionimin e Impiantit.

Gjithashtu edhe në specifikimet teknike përcaktohet “Punimet do të zbatohen **rreptësisht nën mbikqyrjen e një topografi dhe një inxhinieri hidroteknik**, sipas planimetrisë dhe profileve gjatësorë, në prezencë të investitorit dhe supervizorit”

Sa më lart i njejtë arsytim vlen edhe për kërkesën për të disponuar **inxhinier gjeodet / topograf**

*Kërkesa për drejtues teknik **inxhinier elektrik** është bërë duke patur parasysh punimet elektrike që u përcaktuan më lart dhe që i përkasin ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujerave të zeza.*

Ky inxhinier ka kualifikimin e nevojshëm dhe tagrin për realizimin e skemave të rrjeteve elektrike dhe do të garantojë për realizimin sa më të saktë teknikisht të këtij grupi punimesh të objektit.

Jane parashikuar punime elektrike të cilat pasqyrohen në preventiv me realizimin e **impiantit dhe komponenteve perberes të tij. Gjithashtu, në specifikimet teknike të Impiantit në Fq 17 dhe Fq 21, Kabina Elektrike përcaktohet si më poshtë:**

*“Kabina e re elektrike do të jetë pjesë e ndërtesës operacionale dhe do të strehojë transformatorin, centralin MV dhe panelin kryesor LV, të nevojshëm për të furnizuar me energji objektin”*

Gjithashtu në preventiv parashikohen punime të mirefillta të natyrës elektrike si furnizim vendosje Gjenerator Automat, Panel, transformator fuqie, mates fuqie, mates i energjisë elektrike, shtylla beton 20 KV, kabina e re elektrike, punime në TM dhe TU, Instalim elektrik të kabllove, shtresat dhe tubave të furnizuar nga bordi shpërndarjes së tensionit të ulët, kabllo PVC, puseta elektrike, tokezime etj

Eshtë kerkuar Inxhinier Mekanik i cili do të kontrollojë dhe mbikqyre punimet në impiantin e trajtimit të ujerave të zeza, ku venia në punë e impiantit kërkon njohuri të posaçme mekanike dhe elektrike që kanë të bëjnë me funksionimin e impiantit.

Gjithashtu, gjatë realizimit të proceseve të punës për shtrirjen e rrjetit do asistohet nga personel mekanik nën kontrollin e inxhinierit mekanik, duke qenë që tubat kanë diametër dhe peshë të konsiderueshme.

Nderkohe këta punonjes dhe inxhinieri mekanik do të jenë përgjegjës për ecurinë e mjeteve të gërmimit, të transportit etj, të cilat do të përdoren për punimet e këtij objekti si dhe për të gjitha pajisjet mekanike të parashikuara në preventiv.

Inxhinier Elektronik / Inxhinier i teknologjise se informacionit është kerkuar duke patur parasysh punimet për sistemin e Rrjetit IT, sistemin e kamerave, etj.

Në DST janë përcaktuar edhe kërkesat minimale për punonjësit e kualifikuar që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë ofertues për realizimin e këtij objekti. Janë kerkuar punonjes të specializuar dhe të certifikuar me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën;

### **Konkretisht janë kerkuar:**

- Hidraulike, të cilat sic parashtruar më lart janë të nevojshme për ndjekjen dhe realizimin e të gjitha punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve ku punimet hidraulike zënë pjesë të konsiderueshme të punimeve të kontratës konkretisht për proceset furnizim vendosje dhe shtrim tuba në punimet për rrjetin KUZ si dhe punimet në Impiantin e trajtimit të ujerave të zeza, punimet për rrjetin e jashtëm të ujit të pijshëm dhe kanalizimet etj.
- Teknik ndërtimi dhe muratore të cilat janë të nevojshme për ndjekjen e realizimit të punimeve duke patur parasysh punime ndërtimore që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve, mur tulle në suvatime, lysterje etj.
- Punonjësit saldatore janë kerkuar për kryerjen e të gjitha punimeve që kanë të bëjnë me rrjetin e KUZ montimin e tubave dhe rakorderive perkatëse. Këto përcaktime janë bërë edhe në specifikimet teknike të publikuara në SPE për Rrjetin KUZ dhe Impiantin e trajtimit të ujerave të zeza.

- Per kerkesen per specialiste elektriciste njesia e prokurimit eshte bazuar ne punimet elektrike sidomos te kabines elektrike ne TM e TU si dhe instalimeve elektrike qe do behen ne impiantin e trajtimit te ujrave te zeza referuar zerave perkates te preventivit. Konkretisht instalimi elektrik i kablllove, shtresat e tubave të furnizuar nga bordi i shpërndarjes së tensionit të ulët TU, pusetat elektrike apo instalimi i rrjetit te ndricimit etj, furnizim dhe instalim i kablllove të tensionit të ulët, furnizim dhe instalim i shufrave të tokëzimit, furnizim dhe instalim i kanaleve kablllore etj.
- Specialistet karpentier jane kerkuar per te realizuar punimet e armaturave ne beton duke patur parasysh volumin e punimeve me hekur beton referuar preventivit dhe specifikimeve teknike te rrjetit te kanalizimeve Paragrafi **3.4.7 Kapitulli “Punimet e betonit”**.
- Punonjes hekurkthyes jane kerkuar per te realizuar kthimet e hekurit, kornizat e hekurit ne armaturat e betonit ne punimet e betonit. Keta punonjes realizojne kthimet e hekurit, kornizat e hekurit ne armaturat e betonit ne punimet e betonit dhe shtrese betoni. Specialistet hekurkthyes presin, përkulin dhe vendosin rrjeta teli në strukturat e betonit, bejne planet e punës në lidhje me strukturat e hekurit dhe betonit, përgatitin shufra çeliku ose rrjeta çeliku me gjatësinë e kërkuar duke i prerë ato me mjetet perkatese, mbledhin shufrat ose rrjetat përforcuese duke salduar, instaluar në tokë ose prerë në vende të paracaktuara brenda betonit, fabrikojne struktura çeliku dhe vendosja e tyre si strukturë për derdhjet e betonit etj. Keto detyra konkretisht jane specifikuar edhe ne Specifikimet Teknike te KUZ ne te gjitha percaktimet e **Kapitullit 3 “Punimet e betonit”** ku percaktohet nder te tjera se: *“Personeli i përfshirë në prodhimin dhe kontrollin e betonit duhet të ketë njohuritë e duhura, trajnim dhe përvojë për detyrat e veçanta” dhe me konkretisht detyrat per hekurkthyesit jane percaktuar ne **Paragrafin 3.4.6. te ketyre specifikimeve.***
- Punonjesit mekanike jane kerkuar pasi është e rëndesishme që gjatë realizimit të proceseve të punës për shtrirjen e rrjetit KUZ të asistohet nga personel mekanik duke qenë që tubat kane diametër dhe peshë të konsiderueshme. Gjithashtu këta punonjes do të jenë përgjegjës për ecurinë e mjeteve të gërmimit, të transportit etj, të cilat do të përdoren për punimet e këtij objekti.
- Specialist hidroizolues eshte kerkuar per punimet e hidroizolimit te parashikuara ne preventiv dhe te pasqyruara edhe ne specifikimet teknike. Konkretisht Ata do te realizojne proceset e hidroizolimit te betonit ne rezervuarin dekantues, ne rezervuarin septik, ne njesine e paratrajtit, hidroizolimin ne punimet e ndertesave etj.
- Eshte kerkuar 1(një) punonjes i certifikuar me deshmi trajnimi si *“Pergjegjes per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune”*.
- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren



për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjeket të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2013, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

**Argumentimi:** Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 692 datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” (i ndryshuar me VKM-në nr.742, datë 06.11.2003), njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme, duhet të disponojnë si pjesë të stafit ose të nënshkruajë kontratë shërbimi me një mjek të përgjithshëm.

**2.3.4. Operatori Ekonomik të ketë Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”.**

### 2.3.5. Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton	2 (dy) cope
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton	2 (dy) cope
3.	Kamionçina	2 (dy) cope
4.	Fadrome me goma	1 (nje) cope
5.	Rimorkiator për transportin e makinerive	1 (nje) cope
6.	Eskavator me goma për germim dheu 0,25 m <sup>3</sup>	2 ( dy ) cope
7.	Betoniere të vogla	3 (tre) cope
8.	Autopompe Betoni	1 (nje) cope
9.	Vibrator Betoni	3 (tre) cope
10.	Armature Kallëperi betoni	300 m <sup>2</sup>
11.	Makineri Prerese / Sharre Betoni	1 (nje) cope
12.	Autobot uji	1 (nje) cope
13.	Pompe uji	1 (nje) cope

14.	Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	2 (dy) cope
15.	Saldatrice	2 (dy) cope
16.	Pajisje per testimin e linjes se tubave	1 (nje) cope
17.	Matës largësie / Instrument per Topogjeodezim	1 (nje) cope
18.	Matrapik	3 (tre) cope
19.	Sistem Wellpoint	1 (nje) cope
20.	Sharre per prerje asfalti	1 (nje) cope
21.	Aparat hekurthyes	1 (nje) cope
22.	Motogjenerator	1 (nje) cope
23.	Tok Mak per ngjeshje dheu	1 (nje) cope

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 ”Per miratimin e Rregullores per sigurine ne kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore + Jeleke fosforoshente minimumi 60 cope
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton pronesine e mjetit (certifikate pronesie), dokument qe verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (police sigurimi); te vlefshme. Per mjetet e siguruar me qera, te paraqiten dokumentet qe vertetojne rregjistrimin e tij, plus certifikaten e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit te vlefshme. Keto dokumente duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerese te vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet e tjera qe nuk jane te shenuara ne rregjistra publike duhet te paraqitet kontrate noteriale e blerjes / fature tatimore / dokument zhdoganimi te mjetit.

Per pajisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Per pajisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt shoqeruar me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Shenim: Per mjetin ”Rimorkiator per transportin e makinerive”, ne rast se nga Operatori Ekonomik nuk disponohet dokumentacioni certifikate pronesie / kontrate qeraje, nga autoriteti kontraktor do te pranohet edhe dokumenti kontrate huaperdorje.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilin përcaktohet: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... **mjetet dhe pajisjet teknike**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndajnesia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Mjetet e kërkuara përkohje me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të preventivit.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të vëllimeve të punimeve

dhe kohes se realizimit te tyre. Persa me siper, numri i mjeteve eshte percaktuar ne baze ne nevojës se objekti zhvillohet pa cenuar grafikun e percaktuar te punimeve dhe vec te tjerash, objekti ka nje shtrirje te konsiderueshme gjeografike ne qytetin e Burrelit dhe fshatin Muzhak.

Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Makinerite Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 20 ton dhe minimum 10 ton si dhe kamioncinat jane kerkuar per transportin e materialeve qe do te dalin gjate germimeve sipas kerkesave ne preventiv edhe per transport dheu me auto ne volume te konsiderueshme. Gjithashtu do te sherbejne edhe per transportimin e tubave, materialeve te hekurit, materialeve te parafabrikuara etj.

Mjetet Eskavator me goma per germim dheu 0,25m<sup>3</sup> jane kerkuar sipas kerkesave te preventivit.

Makinerite autopompe betoni, vibrator betoni, makineri prerese / sharre betoni, autobot uji jane kerkuar duke patur parasysh punimet ne beton te cilat jane te konsiderueshme ne preventiv dhe qe u cituan edhe me lart.

Pajisja pompe uji eshte kerkuar duke patur parasysh largimin e ujerave nentokesore> kjo percaktohet edhe ne Paragrafin 1.1.2 tek Specifikimet teknike te Impiantit te trajtimit te ujerave te zeza ku citohet

*“Largimi / pompimi i ujerave nëntokësorë nga gërmimet e thella duke përfshirë furnizimin me pompa dhe tuba Për ndërtimin e elementeve të planit të trajtimit në veçanti për rezervuarët e mëdhenj gjatë gërmimeve të thella, uji nëntokësor do të pompohet me pompë”*

Pajisjet Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion” dhe saldatrice jane kerkuar si pajisje te domosdoshme gjate punimeve te percaktuara edhe ne specifikimet teknike kapitujt **per tubacionet ku percaktohet:**

*“Të gjitha nyjet e nevojshme të tubacionit të krijuara nëpërmjet saldimit me elektrofuzion ose saldimit fundor duhet të jenë në përputhje me kërkesat e udhëzuesve përkatës të aplikueshëm “*

Eshte kerkuar pajisje tok mak per ngjeshje dheu e cila sherben gjate procesit te germimeve ku eka punime te tilla si mbushje, rrafshim, ngjeshje.

Sistem Well Point eshte kerkuar ne referim te punimeve qe do te kryhen per kontrollimin e ujerave te pershkruara keto edhe ne specifikimet teknike ku eshte specifikuar:

*Paragrafi 2.6.4, 2.6.5. 2.6.6 Fq 26 “Kontrolli i ujit sipërfaqësor dhe nën sipërfaqësor është pjesë e kërkesave të drenazhimit.*

*Do të mbahet kontroll i përshtatshëm në mënyrë që:*

- *Stabiliteti i shpateve të gërmuara dhe të ndërtuara të mos ndikohet negativisht nga dherat e saturuar, duke përfshirë përgatitjen e shtresave dhe bazamenteve ku kemi kalimin e ujit në të cilët materialet ku janë mbështetur nuk kanë drenazh të lire ose janë subjekt i zgjerimeve ose veprimeve të ngrirjes.*
- *Të kontrollohet erozioni.*
- *Të mos ndodhë përmbytja e gërmimeve ose dëmtimi i strukturave.*
- *Uji sipërfaqësorë të kullojë larg gërmimit.*
- *Gërmimet të mbrohen nga lagia për shkak të ujërave sipërfaqësore, ose të sigurohet që gërmimet të jenë të thata para se të ndërmerren punime të tjera.*

### **Gjithashtu, ne Specifikimet teknike të KUZ është percaktuar:**

Punimet, duke përfshirë materialet që do të përdoren në punime, do të, aty ku është e nevojshme dhe sa më shpejt të mundur, të behën pa prezencë uji dhe të mbrohen nga dëmtimet për shkak të ujit. Uji në kantier dhe uji që futet në kantier do të të largohen me anë të kullimeve të përkohshme ose sistemeve të pompimit ose me anë të metodave të tjera që bëjnë të mundur kryerjen e punimeve pa ujë dhe të mbrojtura nga dëmtimet për shkak të ujit. Balta dhe mbeturinat do të kapen para se uji të shkarkohet nga kantieri. Vendet e shkarkimit të kullimeve të përkohshme dhe sistemeve të pompimit do të jene siç janë miratuar nga Mbikëqyrësi. Kontraktori do të marrë të gjitha masat dhe të marrë miratimet e nevojshme dhe inspektimet nga autoritetet përkatëse për shkarkimin e ujërave në kanale, rrjedha uji ose në det. Punimet përkatëse nuk do të fillojnë para kryerjes së rregullimeve të miratuara për heqjen e ujërave. Kontraktori do të ndërtojë kanale kulluese, gropa drenazhuese, mure me palankola dhe punime të tjera dhe duhet të sigurojë dhe të vendosë në punë pompa, sistem të tubave thithës (**Wellpoints**) ose makineri të tjera që mund të jenë të nevojshme për këtë qëllim.

- Aparat hekurkthyes është kërkuar në lidhje me detyrat që do të kryejë dhe realizojë punonjësi hekurkthyes që u cituan më lart në këtë proces verbal.
- Ndërsa mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier".  
Njësitë e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi.

### **2.3.6. Afati i kryerjes së punimeve:**

**Afati i kryerjes së punimeve është 20 (njetzet) muaj sipas Grafikut të Punimeve të publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

**Argumentimi:** Kjo kerkese eshte bere ne baze te nenit 15 pika 3/a të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: “Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”

Njësia e prokurimit referuar të dhënave teknike dërguar nga sektori i projektimit ku parashikohet dhe afati kryerjes së punimeve, vendosi që afati i punimeve të jete 20 muaj i vlerësuar si nje afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.**

**Argumentimi i specifikimeve teknike:** Bazuar në specifikimet teknike dërguar nga shoqëria projektuese percjelle per publikim, për punimet objekt prokurimi, duke qenë se specifikimet teknike te percjella plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, dhe nenin 40 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e njësies së prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë: **Data: 14.08.2023 Ora**

**11:00 në mënyrë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) .**